

VENDIM
Nr. 436, datë 22.6.2022

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE, TË PROCEDURAVE DHE TË KRITEREVE
TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PËR NJË JETESË TË PAVARUR PËR PERSONAT
ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave, të procedurave dhe të kriterëve të ofrimit të shërbimeve për një jetesë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Kulturës, bashkitë dhe njësitë administrative për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

**RREGULLAT, PROCEDURAT DHE KRITERET E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PËR
NJË JETESË TË PAVARUR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Shërbimet për jetesë të pavarur përshtaten dhe ofrohen nga çdo subjekt publik dhe jopublik, që ofron të mira dhe shërbime për publikun, duke përfshirë institucionet e pavarura, institucionet e administratës shtetërore, bashkitë dhe njësitë administrative.

2. Shërbimet e jetesës së pavarur për personat me aftësi të kufizuara janë shërbime që ofrohen për rritjen e mundësive për zgjedhje të barabarta dhe liri të barabarta me personat e tjerë në shoqëri për përfshirjen dhe integrimin social nëpërmjet vendimeve individuale, të ofruara sipas pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”.

3. Institucionet, të cilat ofrojnë shërbime ekzistuese për personat me aftësi të kufizuara, duhet të garantojnë lehtësi dhe akses për shërbime, në funksion të jetesës së pavarur, për të garantuar pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha sferat e jetës, sipas fushë-veprimtarisë së tyre, si:

- a) strehim;
- b) transport;
- c) shëndetësi;
- ç) kujdes social;
- d) arsimim;
- dh) punësim;
- e) pjesëmarrje në jetën kulturore, sportive;

ë) pjesëmarrje në jetën politike dhe publike.

4. Këto shërbime:

a) trajtojnë nevojat e personit me aftësi të kufizuara, duke respektuar të drejtat dhe dëshirat e tyre;

b) ofrojnë mundësi për zgjedhje dhe autonomi në jetën në komunitet për personat me aftësi të kufizuara.

c) mbulojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha sferat e jetës, përfshirë sferën e punësimit, arsimit dhe aktiviteteve shoqërore, profesionale dhe të kohës së lirë.

ç) marrin në konsideratë të gjitha dëmtimet e nevojat për ndihmë që rrjedhin nga dëmtimi/aftësia e kufizuar;

d) respektojnë të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të udhëzuar ndihmësin personal.

5. Shërbime për jetesë të pavarur, që ofrohen nga subjektet publike dhe private, për personin me aftësi të kufizuara, koordinohen nga struktura përgjegjëse e shërbimit social në bashki/njësinë administrative, sipas planit individual të mbështetjes (PIM), aneksi nr. 1.

6. PIM-i hartohet një herë në vit kalendarik. Mbledhja për PIM-in mbahet jo më herët se 90 ditë nga data e hyrjes në fuqi të planit të ri.

KREU II

KRITERET DHE PROCEDURA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PËR JETESË TË PAVARUR

1. Shërbimet e jetesës së pavarur ofrohen për personat me aftësi të kufizuara, të vlerësuar me vendime të komisioneve multidisiplinare të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në nenin 10, të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, që kërkojnë shërbime.

2. Shërbimet e aksesueshme për jetesë të pavarur përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi për aksesueshmërinë fizike dhe në informacion dhe realizohen në mënyrë progresive.

3. Kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal janë parashikuar në legjislacionin në fuqi për ndihmësin personal.

4. Ofrimi i pajisjeve e mjeteve teknike mbështetëse realizohet sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

5. Procedura për përfitimin e shërbimeve të përshtatjeve të arsyeshme në të gjitha fushat e përmendura në pikën 1, të kreut I, të këtyre rregullave, është, si më poshtë vijon:

a) Përshtatja e arsyeshme është detyrim ligjor për të gjitha subjektet e parashikuara në pikën 1, të kreut I, të këtyre rregullave.

b) Sektorët e shërbimeve të brendshme ose, në mungesë të tyre, sektorët që kryejnë funksionet e tyre në institucione private, koordinojnë punën për zbatimin e rregullave, kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

c) Kërkesa shprehet në fjalë ose me shkrim tek të gjitha subjektet e përcaktuara në pikën 1, kreut I, të këtyre rregullave, nga personi me aftësi të kufizuara, përfaqësuesi i tij, mbështetësi në vendimmarrje ose/dhe ndihmësi personal.

ç) Gjatë shqyrtimit të kërkesës, subjekti, që ka detyrimin për të garantuar përshtatjen e arsyeshme, ka detyrimin të vlerësojë nëse përshtatja e arsyeshme përbën barrë të tepruar.

d) Subjekti kryen një vlerësim të kërkesës, ku përfshihen:

i. natyra dhe kostoja e përshtatjes së nevojshme;

ii. të dhënat për burimet financiare të institucionit/ndërmarrjes, që duhet të sigurojnë përshtatjen e arsyeshme për efekt punësimi dhe aftësimi;

iii. efekte që mund të japin shpenzimet apo burimet financiare ose impakti që mund të ketë kjo përshtatje në funksionimin e institucionit/ndërmarrjes;

iv. llojet e veprimtarive që kryhen, përfshirë përbërjen, strukturën, fuqinë punëtore, largësinë nga vendndodhja, marrëdhënien administrative dhe fiskale që kanë.

6. Pas vlerësimit të kërkesës, institucionet, që kryejnë vlerësimin e përshtatjes së arsyeshme, kthejnë përgjigje brenda 20 ditësh nëse ofrojnë kushtet e përshtatjes së arsyeshme. Në rast se vlerësohet se kërkohen dokumente të tjera, ky afat zgjatet edhe për 10 ditë të tjera.

7. Koordinimi i shërbimeve të jetesës së pavarur në bashki/njësi administrative/qarqe bëhet nga koordinatori i mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara.

8. Detyrat e koordinatorit të mbështetjes për shërbimet e jetesës së pavarur janë:

a) identifikon aktorët ofrues të shërbimeve publike dhe jopublike për jetesën e pavarur;
b) ofron informacion për shërbimet ekzistuese për jetesën e pavarur me shërbime të referimit;
c) përgatit planin individual të mbështetjes (PIM), bazuar në vlerësimin e KMCAP-së dhe në nevojat që paraqiten nga personi me aftësi të kufizuara në sferën ekonomike, sociale, të aftësisimit dhe riaftësimit, arsimore, të formimit profesional e punësimit, të aktiviteteve sportive, çlodhëse e zbavitëse dhe pjesëmarrjen politike dhe në komunitet, që janë thelbësore për jetesën në komunitet të personit me aftësi të kufizuara;

ç) referon dhe bashkëpunon me institucionet dhe organizatat që ofrojnë shërbime që mundësojnë ndihmën ekonomike, zhvillimin e aftësive sociale, aftësimin dhe riaftësimin, arsimimin, formimin profesional e punësimin, aktivitete sportive, çlodhëse dhe zbavitëse, pjesëmarrjen në jetën publike dhe politike;

d) referon personin me aftësi të kufizuara në shërbimet e ndihmesës personale dhe vendimmarrje të mbështetur;

dh) monitoron mbarëvajtjen e planit individual të mbështetjes (PIM) në bashkëpunim me ofruesit e shërbimeve, i cili përmban:

- i. aftësitë, shprehitë e njohuritë;
- ii. cilësitë dhe aktivitetet e parapëlqyera;
- iii. mjetet dhe pajisje ndihmëse të nevojshme;
- iv. familjarë, të afërm ose miqtë që mund të ndihmojnë në realizimin e objektivave;
- v. qendrën për aftësim e riaftësim profesional;
- vi. shërbimet aftësuese dhe riaftësuese në familje dhe komunitet;
- vii. shërbimet e ndihmesës personale dhe të vendimmarrjes së mbështetur.

KREU III ANKIMIMI

1. Për rastet e mosfrimit të shërbimeve të jetesës së pavarur, çdo person me aftësi të kufizuara ka të drejtë:

a) të ankohet te drejtuesi i subjekteve të parashikuara në pikën 1, të kreut I, të këtyre rregullave, në rast se konstaton se rregullat, kriteret apo procedurat e parashikuara në këtë vendim janë shkelur;

b) të marrë informacion në çdo kohë, në lidhje me trajtimin e ankesës dhe të marrë shpjegime në përgjigje të ankesës së tij.

2. Çdo subjekt i parashikuar në pikën 1, të kreut I, të këtyre rregullave, është i detyruar të shqyrtojë ankesën, në mënyrë efektive brenda një periudhe 10-ditore, pas marrjes së kërkesës.

3. Kjo dispozitë nuk e kufizon të drejtën e ankimit në institucione të tjera, sipas legjislacionit në fuqi, si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuara, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe gjykata.

KREU IV
KOORDINIMI DHE INSTITUCIONET E SHËRBIMEVE TË JETESËS SË PAVARUR,
KOORDINIMI NGA INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE

1. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në bashkëpunim me institucionet që punojnë me çështjet e aftësisë së kufizuar, bashkitë dhe njësitë administrative, kanë detyrimin që të koordinojnë punën për zbatimin e rregullave, kritereve dhe procedurave të përcaktuara për shërbimet e jetesës së pavarur.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social për zbatimin e këtij vendimi, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe koordinatorët mbështetës për shërbimet e jetesës së pavarur.

3. Ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar harton udhëzime dhe mbështet bashkitë dhe njësitë administrative për forcimin dhe bashkërendimin e shërbimeve të jetesës së pavarur në nivel kombëtar për personat me aftësi të kufizuara.

4. Çdo subjekt i përmendur në pikën 1, të kreut I, të këtyre rregullave, sipas nevojave të identifikuar, ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuara, ndihmë dhe mbështetje me synim realizimin e zgjedhjeve dhe pritshmërive të vetë personit me aftësi të kufizuara për jetesën e pavarur.

5. Në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore angazhohet struktura përgjegjëse e shërbimit social në bashki/qarqe për të koordinuar procesin dhe ngarkon një punonjës me detyrën e koordinatorit të mbështetjes.

ANEKS 1
PLANI INDIVIDUAL I MBËSHTETJES (PIM) PËR JETESËN E PAVARUR

Emër Mbiemër	
Koordinatori mbështetës	
Bashkia/Njësi Administrative	
Shërbimet aktuale që përfiton personi me aftësi të kufizuara:	
VLERËSIMI I NEVOJAVE PËR SHËRBIME PËR JETESË TË PAVARUR	
Mbrojtje sociale/shëndetësi	
Arsim	
Strehim	
Punësim/formim profesional /përshtatje e arsyeshme	
Aftësi të jetesës së përditshme/aktivitete të përditshme	